



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300110/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë.

**Drejtuar:** z. Loard SALLAKU  
Shef i Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë

**TIRANË**

**Për dijeni:** Drejtues i parë z. Tonin VOCAJ  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 02.02.2023, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar; procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë nr.2 në Tiranë, z. Loard Sallaku, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njohën me qëllimin e inspektimit, shefi i komisariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, si dhe për angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisariati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i inspektimit i shoqëruar nga shefi i komisariatit, inspektoi në vend, gjendjen e dhomave të shoqërimit, u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, si dhe vizitoi zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore, në lidhje verifikimin për sende që ekspozojnë dhunë, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në Komisarariatin e Policisë nr.2 Tiranë, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022, rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për mbylljen e dhomave ekzistuese të sigurisë në Komisarariatin e Policisë nr.2 Tiranë, pasi ato nuk plotësonin kushtet dhe kriteret që të garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të personave të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, si dhe zbatimit të rekomandimit të Komitetit European për Parandalimin e Torturës (CPT).

Ndërkohë, funksionimi i “Bllokut të Sigurisë” në Tiranë ka filluar në datë 22.10.2022. Për sa mësipër rekomandimet që lidhur me kushtet e personave në ambientet e sigurisë nuk janë me rrelevante për këtë komisarariat e do të verifikon në inspektimin që do ti bëhet bllokut të sigurisë.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarariatin e Policisë nr.2 Tiranë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke përfshirë në të ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme, për qëndrim më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës për intervistimin e fëmijëve të mitur, e cila duhet të jetë e kompletuar me orënditë dhe pajisjet e nevojshme, për një ambient sa më miqësor dhe trajtim dinjitoz të tyre.

3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e tualeteve të ndara më vete për femra dhe meshkuj, dhe pajisjen e tyre me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për lyerjen, pastrimin, dhe dezinfektimin e tualetit në ambientet e dhomave të shoqërimit dhe mbajtjen e tij në kushte sa më të përshtatshme.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjes së pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit. Në gjithë krijimin e hapësirave për shkak të largimit të ambienteve të sigurisë

Në përfundim të inspektimit, grupi i monitorimit konstatoi se, në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë, ambienti i shoqërimit **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se: “Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit”<sup>1</sup>.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte 2 (dy) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe qëndrimin e meshkujve, ndërsa dhoma tjetër përdorej për mbajtjen dhe qëndrimin e grave dhe të miturve në konflikt me ligjin. Dhomat e shoqërimit ishin me dimensione 4x3m, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme dhe të pajisura secila me 5 karrige të palëvizshme për qëndrimin ulur, por mungonin tavolinat për personat e shoqëruar. Dhomat e shoqërimit ishin të siguruara me dyer dhe mbylleshin me çelës.

Mungesa e dhomës së shoqërimit për të miturit në konflikt me ligjin është një nga problematikat që paraqitet në këtë komisarariat, duke sjellë si pasojë mos garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike, profesionale dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Dhomat e shoqërimit për të miturit në konflikt me ligjin duhet të ishin ndërtuar siç është parashikuar në Kreun VII, pika 4 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me urdhrin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

---

<sup>1</sup> Kreu VII, pika 4/b e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, parashikon, se kur nuk plotësohen këto standarde për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë, krijohen kushte të nevojshme, të përshtatshme, të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë ku garantohen siguria dhe trajtimi njerëzor i tyre.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që lejonin mundësinë për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe dhomat kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Dhomat ishin të pastra nga ana higjiene-sanitare, por ato kishin nevojë për lyerje. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë teli, për arsye të sigurisë së personave që ndodhen në këto ambiente. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje/ftohje.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë të veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve. Në çdo rast, intervistimi i personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Njëkohësisht edhe kryerja e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe komunikimi i masës së sigurisë të personave për kalimin nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, kryhej në zyrat e punës së punonjësve të policisë.

Korridori në mjedisin e shoqërimit monitorohej nga sistemi i kamerave, ndërsa zyrat e punonjësve të policisë ku merren në pyetje personat e shoqëruar, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave. Administrimi i kamerave kryhej nga specialistët e IT-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 30 ditë.

Në korridorin ku ndodheshin dhomat e shoqërimit ishte një tualet i përbashkët për punonjësit e administratës dhe për personat e shoqëruar. Tualeti ishte i kompletuar me lavaman dhe çezmë por kishte nevojë për lyerjen e tyre, si dhe kishte ujë të rrjedhshëm.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprime ndaj punonjësve të policisë.

Grupi i inspektimit konstatoi, se 2 (dy) ambiente sigurie në këtë komisariat nuk ishin të mbyllur dhe dyllosur sipas procedurës standarde. Sipas informacionit të drejtuesit të komisariatit, dhomat e sigurisë janë të mbyllura me çelës dhe nuk përdoren më, dhe sa i përket personave të arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në “Bllokun e dhomave të sigurisë” Tiranë, në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka ngritur shqetësimin e vazhdueshëm për mbylljen e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë, sipas procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Për sa më lartë, kërkojmë nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për nxjerrjen e akteve ligjor për ndryshimin e këtyre ambienteve për hapësira të tjera të ndryshme në funksionë të institucionit.

Në korridorin e dhomave të shoqërimit u konstatuan ende skara hekuri të montuara në muret e koridoreve, të mbetura nga koha që ato dhoma ishin me destinacion si dhoma sigurie. Prezenca e skarave të hekurit në ambientin e shoqërimit, në pamje të parë përbën për personat e shoqëruar formë presioni psikologjik, si dhe shërben si premisë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave të shoqëruar apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në konceptin juridik, **“Shoqërimi” është veprimi administrativ**, me karakter detyrues (me ose pa vullnetin e personit që shoqërohet) dhe shtrëngues (qoftë edhe forcërisht), që kryhet nga punonjësi i policisë për dërgimin e shtetasve në ambientet e policisë ose në

institucionet e tjera, sipas përcaktimeve dhe procedurave të parashikuara me ligj e aktet nënligjore.

Ekzistenca e një elementi shtrëngues në ushtrimin e kompetencave policore të shoqërimit për verifikim dhe të ushtrimit të kontrollit, tregon një heqje lirie të personit, pavarësisht qëllimit të shoqërimit dhe se sa e shkurtër është koha e qëndrimit në mjediset e policisë të shtetasve. Në këto kushte, ambientet e shoqërimit në polici duhet të jenë të ndërtuara në proporcion të drejtë me veprimet administrative të kryera nga punonjësit e policisë. Konkretisht dhe në nenin 109 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: *“Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë”*.

Sa më lart, në vlerësimin e Avokatit të Popullit, prezenca e skarave të hekurit në mjedisin dhe dhomat e shoqërimit, përbën trajtim jo njerëzor dhe jo dinjitoz të personave që qëndrojnë në këto dhoma, ndaj ato duhet të hiqen sa më parë nga këto ambiente.

Në kohën e inspektimit, në mjediset e policisë së këtij komisariati kishte një person të shoqëruar për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal.

Ndërsa për periudhën Janar-shkurt 2023, në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 205 persona të shoqëruar në mjediset e këtij komisariati, ku saktësisht ishin shoqëruar **193** shtetas madhorë, **9** shtetase gra dhe **3** shtetas të mitur.

Nga verifikimi i dokumentacionit në zyrën e informacionit u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 e procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika, nga ku rezultoi se në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë, mbahej procesverbali përkatës dhe pasi firmosej nga punonjësit e policisë, një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje ruhej në arkivën e institucionit.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisaratin e Policisë nr. 2 Tiranë nuk kishte më ambiente të sigurisë funksionale dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat “Blloku i Sigurisë”, ambient i cili është i ndërtuar sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. “Blloku i Sigurisë” në Tiranë, është një investim i ri ku mbahen dhe sigurohen personat e arrestuar/ndaluar nga të gjitha komisaritet e policisë në varësi të DVP-së Tiranë.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe evidentimi i tyre**

Gjatë kontrollit të dokumentacionit, grupi i inspektimit konstatoi, se Komisariati i Policisë nr.2 Tiranë ishte i plotësuar me regjistrat e përcaktuar sipas procedurave standarde. Ato mbaheshin në zyrën e informacionit, si dhe administroheshin prej punonjësve të policisë të ngarkuar me këtë detyrë.

Konkretisht, në Komisarlatin e Policisë nr.2 Tiranë u konstatua se regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit.

Avokati i Popullit vë theksin se momenti i privimit nga liria është ora në të cilën nis llogaritja e afateve procedurale për efekt të llogaritjes së afatit maksimal prej 10 orë për personat e shoqëruar apo çdo afat tjetër për personat e ndaluar apo arrestuar.

Në zyrën e informacionit të Komisarlatit të Policisë nr.2 Tiranë ishte hapur një regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur të shoqëruar, në bazë dhe të rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim<sup>2</sup>. Për vitin 2023 ishin evidentuar të dhënat për 3 persona të mitur.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarlat nuk kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por sipas informacionit nga stafi dhe shefi i komisarlatit u informuam se do të merren menjëherë masat për pajisjen e këtij institucioni me regjistër.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë nr.2 Tiranë, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

---

<sup>2</sup> Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 “Për garantimin e të drejtave të të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislationit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

Lidhur me këto fakte, Avokati i Popullit i ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar<sup>3</sup>.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisarati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde<sup>4</sup>. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë ishte zhvilluar konform ligjit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Qendrën Spitalore Universitare Nënë-Tereza Tiranë, për të marrë ndihmën mjekësore.

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë, grupi i inspektimit konstatoi se në dhomat e shoqërimit dhe në korridore, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, por ato kishin nevojë të rifreskohen me të reja. Gjithashtu, afishimi i të drejtave duhet të bëhet dhe në vende të tjera të aksesueshme nga

---

<sup>3</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

<sup>4</sup> Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

personat që ndodhen në mjediset e policisë, me qëllim për të dhënë mundësinë e leximit dhe kuptimit të këtyre të drejtave nga ana e tyre.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë nr.2 Tiranë, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”, miratuar me urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe mos ndërtohen në komisarlat ambiente të cilat nuk janë në përputhje me “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”.
2. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen dhe nxjerrjen e akteve ligjor nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe dërgimin e tyre në komisarlatet e qarkut Tiranë, në lidhje me krijimin e ambienteve të shoqërimit për respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve në konflikt me ligjin. Sipas procedura standarde e punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomave për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë ambiente.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme, si tavolinë, karrige për qëndrimin e personave të shoqëruar në konflikt me ligjin.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit dhe tualetit, lysterjen e tyre dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare të tualetit dhe të ambienteve të tjera të Komisarlatit të Policisë nr.2 Tiranë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për mbylljen dhe dyllosjen e 2 dhomave të sigurisë në këtë komisarlat, sipas procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të



*arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

9. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në Komisarriatin e Policisë nr.2 Tiranë.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për heqjen e skarave të hekurit në korridorin e dhomave të shoqërimit, pasi përbën trajtim jo njerëzor dhe jo dinjitoz të personave që qëndrojnë në këto dhoma, dhe shërben si një formë presioni psikologjik, dhe si premisë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave të shoqëruar apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit **30 ditor** sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**